



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ - DEGA E GJYKATËS KAÇANIK

Numri i lëndës: 2022:233157

Datë: 05.04.2024

Numri i dokumentit: 05551209

P.2023:096965

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ - Dega në Kaçanik, Gjyqtari Burim Çaka, me Procesmbajtësen Indira Beqa, në çështjen penale kundër të pandehurve A.Sh, F.R dhe E.R, të shpallur fajtor për veprën penale në bashkëkryerje Vjedhja e Pyellit nga neni 349 paragrafi 2 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Ferizaj me numër PP/II.nr.1649/2022 të datës 25.04.2023, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar më datë 12.03.2024, në seancë publike, në praninë e Prokurorit të Shtetit Fatos Ajvazi, të pandehurve, palëve të dëmtuara M. S. dhe H. Q., më datë 14.03.2024 mori dhe publikisht shpalli, ndërsa me datë 05.04.2024 përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

1. I pandehuri: A.Sh me vendbanim në fshatin "...” Komuna e Ferizaj, i lindur më datën ... në Prishtinë, nga i ati S... dhe e H... e gjinisë G..., me numër personal ..., i pa martuar, ka të kryer shkollën e mesme, i gjendjes së varfër ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

2. I pandehuri: F.R me vendbanim në fshatin "...” Komuna Ferizaj, i lindur më datën ..., në Gjiilan, nga i ati S...dhe e ëma Z... e gjinisë U..., me numër personal ..., i pa martuar, ka të kryer shkollën fillore, i pa punë, i gjendjes së varfër ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

2. I pandehuri: E.R me vendbanim në fshatin ”...” Komuna Ferizaj, i lindur më datën ..., në Prishtinë, nga i ati A... dhe e ëma A... e gjinisë Karaliu, me numër personal ..., i pa martuar, ka të kryer shkollën fillore, i pa punë, i gjendjes së varfër ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

JANË FAJTOR

Sepse më datë 09.10.2021, rreth orës 06:30, në fshatin Koxhaj, Komuna e Kaçanikut, në vendin e quajtur ”...”, të pandehurit me dashje dhe në bashkëkryerje, me qëllim të vjedhjes në pyllin - pronë private e të dëmtuarve H... Q... dhe M... S..., kanë prerë drunjë dhe atë rreth katërdhjetë (40) drunjë të llojit “ahu”, në atë mënyrë që duke përdor sharrë motorike, sharr dore si dhe sëpatë, në pronën e të dëmtuarit M... kanë prerë gjithsej 6.24 m³, të llogaritur në vlerën prej 90 Euro për metër kub, e ku dëmi në total arrin në vlerë 561,60€, ndërsa në pronën e të dëmtuarit ... kanë prerë gjithsej 1.14 m³, të llogaritur në vlerën 90 Euro për metër kub, e ku dëmi në total arrin vlerën prej 102.60 Euro, e që këtë sasia të drunjëve pasi që të pandehurit i kanë prerë të njëjtat i kishin përgatitur për ti bartur me veturën e tipit “...”, mirëpo janë hasur në flagrancë nga të dëmtuarit, dhe më pas janë shoqëruar në Stacionin Policor në Kaçanik.

Me të cilat veprime kanë kryer veprën penale në bashkëkryerje Vjedhja e Pyllit nga neni 349 paragrafi 2 lidhur me nenin 31 të KPRK-së.

Duke u bazuar në nenet 2, 17, 38, 39, 40, 42, 43, 69, 70, 71 dhe 72 të KPRK-së dhe nenit 358, 360, 364, 452, 462 të KPPK-së, të pandehurit i:

GJYKON

I.1. Të pandehurit secilin veç e veç me dënim me burgim në kohëzgjatje nga 60 ditë (Gjashtëdhjetë ditëve), i cili dënim do të ekzekutohet në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi dhe;

I.2. Të pandehurit secilin veç e veç me dënim me gjobë në shumë nga 100€ (Njëqind euro) të cilën gjobë janë të obliguar që secili veç e veç ta paguaj në, në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, në rast mos pagese, dënimi me gjobë do t'i zëvendësohet me dënim me burgim duke llogaritur nga 1 ditë burgim për çdo 20 € (njëzet euro) të gjobës së pa paguar.

II. Obligohen të pandehurit që palës së dëmtuar ... Q., në mënyrë solidare t'ia paguajnë dëmin në shumë 102.60 Euro, në afat prej 30 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

III.1 Konfiskohen në mënyrë të përhershme një sharrë motorike me ngjyrë te kuqe e tipit STARB nje sharr dore ngjyr e zeze e nje ngjyrë e verdhe si dhe një sopatë.

III.2. Sendet e konfiskuara pas plotfuqishmërisë së këtij Aktgjykimi lejohet shitja apo asgjësimi i tyre të cilin do ta bëjë Agjencia për Administrimin e Pasurisë së Sekuestruar apo Konfiskuar.

IV. Obligohen të pandehurit secili veç e veç, që për shpenzimet procedurale dhe paushallit gjyqësor, t'i paguaj kësaj gjykate shumën nga 30€ dhe në emër të Fondit për Kompensimin e Viktimave të Krimit secili veç e veç të paguaj shumën nga 20.00€, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore ne Ferizaj- Departamenti i Përgjithshëm, ka ngritur aktakuzën PP/II.nr.1649/22, të datës 25.04.2023, kundër të pandehurve A.Sh, F.R dhe E.R të shpallur fajtor për veprën penale në bashkëkryerje Vjedhja e Pyllit nga neni 349 paragrafi 2 lidhur me nenin 31 të KPRK-së.

Gjykata duke vepruar sipas kësaj aktakuze si dhe konform nenit 240 te KPPK-së, caktoi dhe mbajti seancën e shqyrtimit fillestar më datë 12.03.2024.

Pas leximit të aktakuzës nga ana e Prokurorit të shtetit, i pandehuri A.Sh ka deklaruar se e pranon fajësinë për të gjitha pikat e aktakuzës, ka deklaruar se është penduar për veprimet e kryera, dhe i ka premtuar gjykatës që nuk do të përsërisë vepra penale në të ardhmen, i ka kërkuar falje palës së dëmtuar.

Pas leximit të aktakuzës nga ana e Prokurorit të shtetit, i pandehuri F.R ka deklaruar se e pranon fajësinë për të gjitha pikat e aktakuzës, ka deklaruar se është penduar për veprimet e kryera, dhe i ka premtuar gjykatës që nuk do të përsërisë vepra penale në të ardhmen, i ka kërkuar falje palës së dëmtuar.

Pas leximit të aktakuzës nga ana e Prokurorit të shtetit, i pandehuri E.R ka deklaruar se e pranon fajësinë për të gjitha pikat e aktakuzës, ka deklaruar se është penduar për veprimet e kryera, dhe i ka premtuar gjykatës që nuk do të përsërisë vepra penale në të ardhmen, i ka kërkuar falje palës së dëmtuar.

Prokurori i Shtetit ka shprehur pikëpamjet lidhur me pranimin e fajësisë së të pandehurve, ka deklaruar se pranimi i fajësisë mbështetet në provat që gjenden në shkresat e lëndës dhe është bërë konform nenit 242 të KPPK-së. Ka deklaruar se nuk e kundërshton pranimin e fajësisë të bërë nga ana e të pandehurve pasi që te njëjtit vullnetarisht u deklaruar dhe pranuan fajësinë për veprën e cila u vihet në barrë, dhe ky pranim i fajësisë gjen mbështetje edhe në provat dhe faktet mbi bazën e të cilave është ngritur aktakuza dhe nuk ka asnjë rrethanë e cila rrethanë të njëjtit mund t'i përjashtoj nga përgjegjësia penale dhe pranimi i fajësisë është bërë në pajtim me nenin 242 të KPP-së, andaj kërkoj nga gjykata që të aprovoj pranimin e fajësisë, të pandehurit t'i shpall fajtor dhe bazuar në rrethanat të cilat ndikojnë në matjen e dënimit të cilat rrethana janë përmendur respektivisht janë listuar edhe në aktakuzë ndaj të pandehurve gjykata të shqiptoj dënim me burgim sepse vetëm me këtë lloj të dënimit do të arrihet qëllimi i dënimit. Po ashtu propozoj që të bëhet edhe konfiskimi i përehershem i sendeve të cilat janë përdorur për kryerjen e veprës penale, konkretisht një sharrë motorike me ngjyr të kuqe e tipit STARB një sharrë dore ngjyr e zeze e një ngjyrë e verdhë si dhe një sapatë.

Pala e dëmtuar ... Q... ka deklaruar se i bashkëngjitet ndjekjes penale dhe përqarshtron kërkesë pasurore juridike.

Pala e dëmtuar M. S. ka deklaruar se nuk kërkon dëm.

Vlerësimi i pranimit të fajësisë

Pasi që të pandehurit e kanë pranuar fajësinë, në fillimin e shqyrtimit fillestar, gjykata për të vlerësuar pranimin e fajësisë e duke pasur parasysh edhe pikëpamjet e Prokurorit të Shtetit, shqyrtoi me kujdes faktet e parapara nga neni 242 par 2 të KPPK-së dhe me këtë rast vlerësoi se: të pandehurit e kanë kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajit; Pranimi është bërë vullnetarisht, pranimi i fajit mbështet në faktet dhe prova materiale të rastit konkret dhe atë me provat e paraqitura nga Prokuroria e Shtetit të cilat gjenden në shkresat e lëndës, të gjitha këto prova të mbledhura gjatë procedurës hetimore; Akuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike.

Duke vlerësuar në aspektin figurës së veprës penale gjykata konstatoi se në veprimet e të pandehurve ekzistojnë të gjitha tiparet objektive dhe subjektive të veprës penale në bashkëkryerje Vjedhja e Pyllit nga neni 349 paragrafi 2 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, si në mënyrë kohë dhe vend si në dispozitivin e këtij aktgjykimi.

Rrethanat për matjen e dënimit

Me rastin e matjes së llojit dhe lartësisë së dënimit për të pandehurin A.Sh, gjykata vlerësoj rrethanat në kuptim të nenit 69, 70 të KPRK-së, si rrethanë posaçërisht lehtësuese gjeti se të njëjtit e kanë pranuar fajësinë në shqyrtim fillestar, deklarin se është penduar për veprimet e kryera, gjendjen e varfër ekonomike, mbajtës i familjes, premtimin e tyre se nuk do të përsërisin vepra penale të njëjta në të ardhmen, ndërsa si rrethanë rënduese gjykata gjeti se i pandehuri është recidivist, e cila dëshmohet nga certifikata mbi dënimet penale të lëshuar nga Sistemi qendror i evidencës penale, e cila është pjesë e shkresave të lëndës.

Me rastin e matjes së llojit dhe lartësisë së dënimit për të pandehurin F.R, gjykata vlerësoj rrethanat në kuptim të nenit 69, 70 të KPRK-së, si rrethanë posaçërisht lehtësuese gjeti se të njëjtit e kanë pranuar fajësinë në shqyrtim fillestar, deklarin se është penduar për veprimet e kryera, gjendjen e varfër ekonomike, premtimin e tyre se nuk do të përsërisin vepra penale të njëjta në të ardhmen, ndërsa si rrethanë rënduese gjykata gjeti se i njëjti është recidivist, e cila

dëshmohet nga certifikata mbi dënimet penale të lëshuar nga Sistemi qendror i evidencës penale, e cila është pjesë e shkresave të lëndës.

Me rastin e matjes së llojit dhe lartësisë së dënimit për të pandehurin E.R, gjykata vlerësoj rrethanat në kuptim të nenit 69, 70 të KPRK-së, si rrethanë posaçërisht lehtësuese gjeti se të njëjtit e kanë pranuar fajësinë në shqyrtim fillestar, deklarin se është penduar për veprimet e kryera, gjendjen e varfër ekonomike, premtimin e tyre se nuk do të përsërisin vepra penale të njëjta në të ardhmen, ndërsa si rrethanë rënduese gjykata gjeti se i pandehuri është recidivist, e cila dëshmohet nga certifikata mbi dënimet penale të lëshuar nga Sistemi qendror i evidencës penale, e cila është pjesë e shkresave të lëndës.

Gjykata, të pandehurit iu shqiptoi dënimin si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, duke e marrë për bazë minimumin dhe maksimumin dhe qëllimin e dënimit dhe duke u bazuar në rrethanat lehtësuese dhe është i bindur se edhe me një dënim të tillë, do të arrihet qëllimi i përgjithshëm i dënimeve i paraparë në nenin 38 të KPRK-së, përkatësisht dënimi i shqiptuar është plotësisht i justifikueshëm, në përshtatje me rrethanat e kryerjes, rrezikshmërinë e saj dhe të autorit të saj, që do të shërbej në parandalimin e kryesve nga kryerja e veprave penale në të ardhmen (preventiva speciale) si dhe do të arrihet qëllimi i përgjithshëm i dënimit.

Vendimi mbi kërkesën pasurore juridike

Pala e dëmtuar M. S. nuk ka parashtruar kërkesë pasurore juridike.

Duke u bazuar në nenin 462 të KPPRK-ës, gjykata i ka obliguar të pandehurit që palës së dëmtuar ... Q....në mënyrë solidarë të i'a paguajnë dëmin e shkaktuar në shumën prej 102.60 Euro duke u bazuar në pranimin e fajësisë për të gjitha pikat e aktakuzës.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale

Gjykata vendimin mbi shpenzime e procedurës dhe paushallit gjyqësor e mori konform neneve 450 dhe 452 të KPPK-ës.

Gjykata vendimin mbi Kompensimin e Viktimave të Krimit e mori konform nenit 36 paragrafi 3 pika 3.1 të ligjit Nr. 08/L-109 për Kompensimin e Viktimave të Krimit.

Mbi bazën e të dhënave si më lartë, në bazë të neneve 242, 364 dhe 462 të KPPK-së, u vendos si në dispozitivin e këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ

Dega në Kaçanik

P.2023:096965, datë 05.04.2024

Gjyqtari:
Burim Çaka

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi mundet të ushtrohet ankesë në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi. Ankesa i drejtohet Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj Gjykate, në kopje të mjaftueshme.